


# Performanca e Buxhetit 2018



## NË KËTË RAPORT


**Periudha raportimit:** Janar - Dhjetor 2018

**Statusi raportit:** Raporti bazohet në të dhëna të konsoliduara të zbatimit të buxhetit për bashkinë Durrës gjatë vitit 2018 dhe është miratuar në Këshillin Bashkiak

***Përmbledhje mbi situatën financiare, të ardhurat, shpenzimet sipas programeve si edhe rezultatet kryesore të ekzekutimit të buxhetit për vitin 2018***

*Ky raport është përgatitur nga Bashkia Durrës me asistencën e Projektit "Bashki të Forta". Për më shumë informacion kontaktoni Zj.Valbona Qiriako në adresën [valbona.qiriako@yahoo.com](mailto:valbona.qiriako@yahoo.com)*

# TË DHËNA TË PËRGJITHSHME



Popullsia: Censuri (2011) 203,943 banorë

Rregjistri Civil 323,147 banorë

Sipërfaqja: 341,9 km<sup>2</sup>


Dendësia: Censuri (2011) 596 banorë/km<sup>2</sup>

Rregjistri Civil 945 banorë/km<sup>2</sup>

Nëndarjet Administrative: 6

(1) Durrës (2) Sukth (3) Ishmi (4) Katundi i Ri  
(5) Rashbull (6) Manëz

## Rezultatet në zgjedhjet vendore të vitit 2015 si më poshtë:



## Shpërndarja e anëtarëve:

16 Anëtarë
14 Anëtarë
13 Anëtarë
2 Anëtarë
2 Anëtarë
2 Anëtarë
1 Anëtarë
1 Anëtarë

**EKZEKUTIVI** Numri i përgjithshëm i zgjedhësve të regjistruar në Bashkinë Durrës për zgjedhjet vendore të vitit 2015 ishte 233.509 persona. Pjesëmarrja e votuesve në zgjedhjet e fundit lokale ishte 43%. Këshilli Bashkiak përbëhet nga 51 anëtarë të grupuar midis partive politike PS, PD, LSI, PDIU dhe PR.

Kryetari i Bashkisë Durrës është **Z. Vangjush DAKO**.

13 departamentet e Bashkisë janë: Ekonomi dhe Financë; Buxheti, Tatim Taksa Vendore, Politikat e Zhvillimit, Shërbimet Publike, Bujqësia dhe Pyjet, Shërbimet Sociale, Planifikim dhe Kontrolli i Territorit, Policia Bashkiake, Mbrojtja e Territorit, Ligjore, Administratë dhe Burimet Njerëzore, Arsim dhe Edukim;

**EKONOMIA** Me mbi 13.510 aktivitete ekonomike dhe 15% e investimeve të huaja, Durrësi është renditur në vendin e dytë si ekonomia më e fortë e vendit, pas Tiranës. Turizmi veror dhe kulturor është një industri me ndikim të rëndësishëm në ekonominë e Durrësit. Me mbi 380.000 vizitorë në vit, Durrësi është zona më e rëndësishme e vendit në lidhje me turizmin masiv.

# SITUATA FINANCIARE

- ⇒ Rritja e financimit të shërbimeve publike nga burimet e brendshme të bashkisë prej të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore pa rritur barrën fiskale.
- ⇒ Të ardhurat e veta të bashkisë zënë një peshë edhe më të madhe në burimet e bashkisë duke e rritur kontributin e tyre në tërësinë e fondeve buxhetore të bashkisë me 15%, si rrjedhojë e tarifave vendore në rritje (43% rritje kundrejt një viti më parë).
- ⇒ Përmirësim i menaxhimit buxhetor dhe qëndrueshmëri financiare duke kryer shpenzime buxhetore brenda burimeve të të ardhurave të mbledhura.
- ⇒ Menaxhim i kujdesshëm i fondeve të bashkisë duke kryer shpenzime 100% në nivelin e të burimeve financiare.

## 2018 Vs 2017

### Treguesit


Norma e detyrimeve të vonuara ndaj totalit të të ardhurave

Norma e shpenzimeve në politikat sociale ndaj totalit të shpenzimeve

Norma e të ardhurave nga burimet e veta ndaj totalit të të ardhurave

Norma e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore ndaj totalit të të ardhurave

Norma e totalit të shpenzimeve ndaj totalit të të ardhurave



Burimi Informacionit

"FPT 2019-2022 - Bashkia Durrës"

## Fakt 2016, 2017, 2018

### Treguesit


Norma e detyrimeve të vonuara ndaj totalit të të ardhurave

Norma e shpenzimeve në politikat sociale ndaj totalit të shpenzimeve

Norma e të ardhurave nga burimet e veta ndaj totalit të të ardhurave

Norma e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore ndaj totalit të të ardhurave

Norma e totalit të shpenzimeve ndaj totalit të të ardhurave



Burimi i Informacionit

"FPT 2019-2022 - Bashkia Durrës"

# BUXHETI 2018

## Burimet e financimit planifikimi 2018

- ⇒ Transferta e pakushtëzuar
- ⇒ Transferta specifike
- ⇒ Të ardhurat nga taksat dhe tarifat
- ⇒ Të ardhura të trashëguara nga viti 2017

**Buxheti për vitin 2018 = 3.428.671 mijë lekë**




## Shërbimet kryesore të ofruara nga bashkia për vitin 2018


- |  |                                     |
|--|-------------------------------------|
| ⇒ Planifikim, Menaxhim, Administrim                        | ⇒ Zhvillimi i komunitetit           |
| ⇒ Shërbime të Përgjithshme                                 | ⇒ Furnizimi me ujë                  |
| ⇒ Shërbimet e policisë                                     | ⇒ Ndrçimi i rrugëve                 |
| ⇒ Rendi publik dhe masat e sigurisë                        | ⇒ Shërbimet rekreative dhe sportive |
| ⇒ Çështjet e përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës | ⇒ Shërbimet kulturore               |
| ⇒ Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia                    | ⇒ Arsimi bazë dhe parashkollor      |
| ⇒ Transporti   | ⇒ Arsimi i mesëm                    |
| ⇒ Industri të tjera  | ⇒ Shërbime plotësuese në arsim      |
| ⇒ Menaxhimi i i mbetjeve                                   | ⇒ Sëmundje dhe paaftësi             |
| ⇒ Menaxhimi i ujrave të zeza                               | ⇒ Të moshuarit                      |
| ⇒ Reduktimi i ndotjes                                      | ⇒ Familje dhe fëmijë                |
| ⇒ Mbrojtja e mjedisit                                      | ⇒ Strehimi                          |
| ⇒ Zhvillimi i strehimit                                    | ⇒ Ndihma Ekonomike                  |
|  | ⇒ Shërbimet e mbrojtjes nga zjarri  |

**Buxheti i realizuar për vitin 2018 = 2.273.019 mijë lekë**

# TË ARDHURAT 2018



Burimi: FPT 2019-2021 & Raporti Monitorimit,



Burimi: FPT 2019-2021 & Raporti Monitorimit 2018 Bashkia Durrës


# SHPENZIMET

*Bashkia Durrës i kushton vëmendje gjithnjë e më shumë në rritje arsimit bazë dhe parashkollor dhe infrastrukturës.*

*Programet buxhetore më të financuara gjatë vitit 2018, që përbënin rreth 70% të buxhetit, ashtu sikurse parashikohej janë:*

- A. Arsimi Bazë dhe Parashkollor
- B. Menaxhimi i Mbetjeve
- C. Infrastruktura Rrugore (urbane dhe rurale) dhe transportin publik
- D. Organet Egzekutive dhe Legjislative
- E. Zhvillimi i Komunitetit
- F. Familjet dhe Fëmijët

**Pesha e Programeve buxhetore viti 2018**



Shpenzimet sipas Programeve Buxhetore

Emertimi	Fakt 2017	Plan 2018	Fakt 2018	% 2018 Fakt kundrejt Plan	% Fakt 2018 kundrejt 2017 Fakt
Arsimi bazë dhe parashkollor	351,255	686,503	384,535	56.01%	91.35%
Arsimi i mesëm	82,446	157,912	75,125	47.57%	109.75%
Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia	60,667	87,301	76,898	88.08%	78.89%
Çështjet e përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës	3,012	12,205	11,918	97.65%	25.27%
Familje dhe fëmijë	77,177	137,699	103,508	75.17%	74.56%
Furnizimi me ujë	0	41,580	41,580	100.00%	0.00%
Industri të tjera	1,689	123,739	68,856	55.65%	2.45%
Mbrojtja e mjedisit	0	1,875	1,801	96.05%	0.00%
Menaxhimi i i mbetjeve	367,183	395,240	363,021	91.85%	101.15%
Menaxhimi i ujrave të zeza	0	8,617	4,480	51.99%	0.00%
Ndihma Ekonomike	24,343	15,530	14,877	95.80%	163.63%
Ndriçimi i rrugëve	80,980	110,451	82,833	75.00%	97.76%
Organet ekzekutive dhe legjislative, Çështjet financiare dhe fiskale	344,697	281,350	243,481	86.54%	141.57%
Rendi publik dhe masat e sigurisë	0	3,211	3,088	96.17%	0.00%
Sëmundje dhe paafësi	2,886	7,423	5,775	77.80%	49.97%
Shërbime plotësuese në arsim	0	4,560	4,560	100.00%	0.00%
Shërbime të Përgjithshme	31,336	78,323	52,383	66.88%	59.82%
Shërbimet e mbrojtjes nga zjarri	54,940	70,462	64,383	91.37%	85.33%
Shërbimet e policisë	0	31,663	28,158	88.93%	0.00%
Shërbimet kulturore	58,462	110,207	75,771	68.75%	77.16%
Shërbimet rekreative dhe sportive	138,741	180,667	180,667	83.81%	76.79%
Strehimi	147,002	61,661	45,732	74.17%	321.44%
Të moshuarit	17,595	20,298	18,753	92.39%	93.82%
Transporti	986,973	752,505	308,445	40.99%	319.98%
Zhvillimi i komunitetit	0	12,796	12,391	96.83%	0.00%
TOT	2,831,384	3,428,671	2,273,019	66.29%	124.56%


# SHPENZIMET

**Të ndara sipas aktivitetit ekonomik, shpenzimet kapitale përbëjnë 28.4% të totalit të shpenzimeve kurse ato operative 71.6%. Vihet re një rënie e shpenzimeve kapitale dhe operative gjatë vitit 2018 kundrejt vitit të mëparshëm.**

**Në grafik paraqitet % e realizimit ndaj planifikimit, ndërsa tabela me poshtë liston investimet me të rëndësishme të bashkisë.**

Shpenzime sipas Klasifikimit Ekonomik në Lekë


## Shpenzime



Burimi i Informacionit  
Raporti i Monitorimit 2018  
Bashkia Durres

Projektet e Investimeve

## Investimet sipas programeve në lekë



Burimi i Informacionit  
"Raporti i Monitorimit 2018"  
Bashkia Durres



# TREGUESIT E PERFORMANCËS

Rezultatet vjetore të treguesve të performancës buxhetore



Bashkia ka rritur performancën e përdorimit të fondeve buxhetore. Kjo rritje ka ardhur edhe në sajë të rritjes së transparencës së vendimarrjes bashkiake.

Të gjitha mbledhjet e Këshillit Bashkiak kanë qenë të hapura dhe pjesa më e madhe e vendimeve që detyrojnë konsultimin me publikun janë diskutuar paraprakisht me banorët.

Disa arritje të rëndësishme të përmirësimit të shërbimeve ofruar komunitetit vendor falë rritjes jo vetëm të burimeve financiare, por edhe të kapaciteteve njerëzore të bashkisë janë renditur më poshtë, tregues performance sipas programeve.



# PROGRAMI

## MBROJTJA NGA ZJARRI DHE MBROJTJA CIVILE

### Objektivi i programit -

*Përmirësimi i shërbimeve dhe infrastrukturës së shuarjes së zjarrit dhe shpëtimit*

*Realizimi i shpenzimeve : 91% e planifikimit, 64.383 mijë lekë dhe përbën 3% të buxhetit*



### TREGUES PERFORMANCE:

*Bashkia ka arritur objektivin si rrjedhojë e përmirësimit të treguesve të performancës së këtij programi buxhetor si:*

- ⇒ *Bashkia ka në dispozicion 2 stacione të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit*
- ⇒ *Numri i punonjësve në këto stacione është 48*
- ⇒ *Janë rritur të ardhurat nga tarifat për shërbimin ndaj të tretëve me 3.6%*
  - ⇒ *Janë rritur fondet e dedikuara me 13%*
  - ⇒ *Është rritur numri total i rasteve të menaxhuara me 15%*
- ⇒ *Koha e daljes nga stacioni në sekonda nga 60 sekonda është ulur në 55 sekonda*
- ⇒ *Është rritur numri i inspektimeve tek të tretët për parandalimin e rasteve të zjarrit me 2%*

# PROGRAMI

## MENAXHIMI SISTEMIT TË VADITJES DHE KULLIMIT



**Objektiva**  
Përmirësimi i infrastrukturës së  
sistemit të vaditjes dhe kullimit

*Bashkia ka përmirësuar ndjeshëm situatën për familjet  
fermere dhe biznesin bujqësor duke përmirësuar  
infrastrukturën e vaditjes dhe kullimit*

### TREGUES PERFORMANCE

Është rritur sipërfaqja e tokës së kultivuar  
me rreth 3.3% duke shkuar në 19.286 ha

Është rritur sipërfaqja e tokës  
bujqësore me rreth 10% duke shkuar në  
21.406 ha

#### ◆ TP 1. Përmirësimi i shërbimit


-Rritja e sipërfaqes bujqësore e  
mbuluar me ujitje (trendi në %)

-Rritja e sipërfaqes bujqësore së  
mbuluar me kullim (trendi në %)

#### ◆ TP 2. Përmirësimi i sistemit

-Përmirësimi i rrjetit të kullimit  
të pastruar apo shtuar (në % kundrejt  
rrjetit total)

-Përmirësimi i rrjetit vaditjes të  
pastruar apo shtuar (% kundrejt rrjetit  
total)



# PROGRAMI

## ADMINISTRIMI I PYJEVE DHE KULLOTAVE

### Objektivi i programit

Rritja e produkteve nga pyjet dhe kullotat

Realizimi i shpenzimeve : rreth 88% e planifikimit, 76.898 mijë lekë, 3% e buxhetit

*Bashkia ka arritur objektivin si rrjedhojë e përmirësimit të të gjithë treguesve të performancës së këtij programi buxhetor*

*Është rritur numri i punonjësve në shërbimin e menaxhimit të fondit pyjor dhe kullosor nga 3 në 8*



### TREGUES PERFORMANCE

- ◆ **TP1.** Planet e menaxhimit të fondit pyjor dhe kullosor
- ◆ **TP2.** Rritja e inspektimit të fondit pyjor dhe kullosor
- ◆ **TP3.** Rritja e monitorimit të fondit pyjor dhe kullosor
- ◆ **TP4.** Efienca e përdorimit të buxhetit të alokuar për menaxhimin e fondit pyjor dhe kullosor
- ◆ **TP5.** Përmirësimi i fondit pyjor dhe kullosor

# PROGRAMI

## RRJETI RRUGOR DHE TRANSPORTI

### Objektivi i programit

Bashkia siguron akses rrugor të të gjitha njësive administrative të saj tek shërbimet bazike

*Realizimi i shpenzimeve : rreth 41% e planifikimit, 308.445 mijë lekë dhe përbën 14% të buxhetit*

### TREGUES PERFORMANCE


⇒ **TP1.** Zgjerimi i rrjetit rrugor:

- Rrugë rurale
- Rrugë urbane

⇒ **TP2.** Eficienca e alokimit të buxhetit për përmirësimin e infrastrukturës rrugore:

- Rrugë rurale
- Rrugë urbane

⇒ **TP3.** Përmirësimi i sigurisë rrugore





# PROGRAMI

## TRANSPORTI PUBLIK

### TREGUES PERFORMANCE

#### Objektivi i programit

Sigurimi i transportit publik për komunitetin

*Janë rritur fondet e dedikuara për transportin publik; janë shpërndarë 3.100 abone dhe janë mbështetur 18.900 persona të kategorive të nevojë.*

- ♦ **TP1.** Numri i linjave të transportit publik urban dhe interurban (rritja vjetore në %)
  - rritja vjetore e linjave interurbane
  - rritja vjetore e linjave urbane
- ♦ **TP2.** Numri i mjeteve të transportit publik (urban dhe interurban) rritja vjetore në %
  - rritja vjetore e mjeteve interurbane
  - rritja vjetore e mjeteve urbane
- ♦ **TP3.** Buxheti i alokuar për transportin publik
- ♦ **TP4.** Përmirësimi i transportit publik
- ♦ **TP5.** Mbështetja e transportit publik për kategoritë e veçanta të njerëzve në nevojë



# PROGRAMI

## MENAXHIMI MBETJEVE BASHKIAKE

Objektivi i programit

Përmirësimi i menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane




Realizimi i shpenzimeve :

rreth 92% e planifikimit, 363.021 mijë lekë dhe përbën rreth 16% të buxhetit

### TREGUES PERFORMANCE

Është rritur sipërfaqja dhe numri i popullsisë së mbuluar me shërbim nga bashkia; janë rritur të ardhurat nga tarifat e shërbimit të mbetjeve me rreth 50% duke rritur cilësinë e shërbimit dhe sasinë e mbetjeve të trajtuara me rreth 2%

Menaxhimi mbetjeve urbane  
2015-2018



- ◆ **TP 1.** % e popullatës e mbuluar me shërbim
- ◆ **TP 2.** % e sipërfaqes së territorit e mbuluar me shërbim
- ◆ **TP 3.** % kostos së shërbimit e mbuluar nga tarifa

# PROGRAMI


## SHËRBIMI I UJIT TË PIJSHËM DHE KANALIZIMET

### Objektivi i programit

Përminësimi i ofrimit të shërbimit të ujit të pijshëm

Përminësimi i menaxhimit të ujërave të përdorura (zeza dhe bardha) / shërbimeve sanitare

Realizimi i shpenzimeve : 100% e planifikimit, 41.580 mijë lekë dhe përbën rreth 2% të buxhetit



### TREGUES PERFORMANCE

Është rritur numri i popullatës mbuluar nga shërbimi i ujit të pijshëm (1.2%) dhe menaxhimit të ujërave të përdorura (7.8%). Kjo ka sjellë dhe rritje të të ardhurave nga ky shërbim me rreth 28% duke shtuar sasinë e menaxhuar të ujërave në territorin e bashkisë.

- ◆ **TP 1.** % e popullatës mbuluar me ujë të pijshëm
- ◆ **TP 2.** % e popullatës mbuluar me kanalizime sanitare
- ◆ **TP 3.** % e kostos së shërbimit të ujit të pijshëm e mbuluar nga tarifa
- ◆ **TP 4.** % e kostos së shërbimit të kanalizimeve e mbuluar nga tarifa
- ◆ **TP 5.** Kohëzgjatja e u furnizimit me ujë të pijshëm (orë në ditë)



# PROGRAMI

## NDRIÇIMI PUBLIK

### Objektivi i programit

Rritja e sigurisë së komunitetit  
nëpërmjet ndricimit të hapësirave  
publike

Realizimi i shpenzimeve : 75% e  
planifikimit, 82.833 mijë lekë dhe  
përbën rreth 4% të buxhetit

### TREGUES PERFORMANCE

Është rritur norma e mbulimit të kostos së shërbimit në 72% nga 44% në vitin 2017, si rezultat i rritjes së të ardhurave të mbledhura nga bashkia për këtë shërbim me 7% krahasuar me një vit më parë.

- TP 1.** Tarifa e ndricimit e mbledhur ne mijë lekë
- TP 2.** Kosto e ndricimit të rrugëve dhe hapësirave publike në mijë lekë
- TP 3.** Norma e mbulimit të kostos së shërbimit në %

